



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 462/9 prot.

Tiranë, më 12.11.2018

**VENDIM**

**Nr.88, datë 12.11.2018**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 72, DATË 20.07.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 72, datë 20.07.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës \*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 462 prot., datë 22.05.2018”, në Bashkinë Pogradec,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 462 prot., datë 22.05.2018, punonjësja \*\*\*\*\* me detyrë “Inspektor” në Inspektoratin e Mbrojtjes së Konsumatorit, pranë Bashkisë Pogradec ka informuar Komisionerin se, me Vendimin nr. 83, datë 11.5.2018, të Njesisë Përgjegjëse, është larguar nga shërbimi civil, për shkak të ndryshimit të strukturës së Bashkisë Pogradec. Ankuesja ka ngritur pretendimet se vendimi për largimin nga shërbimi civil është marrë në kundërshtim me pikën 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe se dëmshpërblimi nuk është llogaritur në bazë të vjetërsisë në shërbimin civil.

Pas hetimit administrativ të këtij rasti, Komisioneri ka përmbyllur procesin me Vendimin Nr. 72, datë 20.07.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të

marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës \*\*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 462 prot., datë 22.05.2018”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Pogradec, që në bazë të pikës 3, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të drejtojë procesin administrativ të ndryshimit të pikës 3, të aktit të lirit nga shërbimi civil nr. 83, datë 11.5.2018, duke e dëshmshpërblyer punonjësën \*\*\*\*\*\* me pagën e 12 muajve (të shtohen edhe 6 muaj, pagesë), për shkak të vjetërsisë së saj në punë mbi 9 vjet, si nëpunëse civile.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Bashkisë Pogradec, Njësia Përgjegjëse e institucionit dhe punonjësja \*\*\*\*\*\*.

3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat 15 ditë.

4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.”

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr. 72, datë 20.07.2018, Bashkia Pogradec ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi.

Konkretisht, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pogradec, në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të vendimit objekt verifikimi, ka nxjerrë vendimin nr. 216 prot., datë 07.08.2018, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 83, datë 11.05.2018, “Për lirim nga shërbimin civil i nëpunësit \*\*\*\*\*\*”, në të cilin parashikohet sa më poshtë:

“1. Ndryshimin e pikës 3 të Vendimit nr. 83, datë 11.05.2018, “Për lirim nga shërbimin civil i nëpunësit \*\*\*\*\*\*”, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

2. \*\*\*\*\*\* të dëshmshpërblehet me 12 muaj pagesë gjithsej për arsye të lirit nga shërbimi civil, për shkak se nëpunësja ka mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunëse civile.

...”

Për sa u parashtua më sipër, rezulton se nga ana e institucionit, Bashkia Pogradec, janë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues Nr. 72, datë 20.07.2018, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës \*\*\*\*\*\*, protokolluar me nr. 462 prot., datë 22.5.2018”,

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së

*Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,*

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 72, datë 20.07.2018, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës \*\*\*\*\*”, protokolluar me nr. 462 prot., datë 22.5.2018”.*
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Bashkia Pogradec, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 72, datë 20.07.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Pogradec, dhe ankuesja \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**